



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 119

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI NË
KONTEKSTIN E ADERIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË
MALIT TË ZI NË KONTEKSTIN E ADERIMIT NË BASHKIMIN
EVROPIAN**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen në kontekstin e aderimit në Bashkimin Evropian, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi.

Neni 2
Ratifikimi i marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi, në kontekstin e aderimit në Bashkimin Evropian.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Bashkëngjitur me këtë ligj është Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi në kontekstin e Aderimit në Bashkimin Evropian.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë (15) pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-119
22 shkurt 2022

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës